



**HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A**  
**KOMISIONI I AUDITIMIT**

**Nr. I/161**

**Datë: 08.11.2024**

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit Nr. 03L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe në pajtim me Ligjin 04L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03L-087, në bazë të nenit 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative si dhe në bazë të Nenit 10 të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit dhe të Emërimit në Pozitat e Zyrtarëve të Lartë Nr. I/32 të datës 29.02.2024, Komisioni i Auditimit i HK-Trainkos Sh.A në Mbledhjen Nr. 14, të mbajtur më 08.11.2024, pas shqyrtimit/verifikimit të aplikacioneve në Konkursin për pozitën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm të datës 01.10.2024 njëzëri nxori këtë:

**VENDIM**

**I.** Për krijimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e kualifikimit për pozitën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm sipas Konkursit të datës 01.10.2024:

- 1. Avni Murati;**
- 2. Kujtim Greiçevci;**
- 3. Valmir Musliu.**

**II.** Të gjithë kandidatët, në listën si më lart, do të ftohen për intervistim për pozitën e Zyrtarit për Auditim të Brendshëm sipas Konkursit të datës 01.10.2024.

**Arsyetim**

Brenda afatit sa konkursi ka qenë i hapur, 1 tetor deri më 31 tetor 2024, kanë qenë gjithsej tri (3) aplikime të pranuar. Duke pasur parasysh kushtet dhe kriteret ligjore, të cilat është kërkuar që të plotësohen nga kandidatët në Konkursin për Auditor të Brendshëm, të publikuar më 01.10.2024, Komisioni pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të aplikantëve në këtë Konkurs, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Në emër të Komisionit të Auditimit**

**Ruzhdi Zeqiri, Kryesues**